

(EMRI ZYRTAR DHE I PLOTË I XHAMISË)
(Qendra Kulturore „Shtëpia e Paqës“)
(Kulturzentrum „Haus des Friedens“)

S T A T U T I

Zürich 28.09.2025

1. EMRI DHE SELIA

- 1.1. Nën emrin **Qendra Kulturore „Shtëpia e Paqës“** ekziston një shoqatë fetare (xhami), politikisht neutrale dhe jofitimprurëse sipas nenit 60 ff të Kodit Civil Zvicëran.
- 1.2. Selia e QKSHP është në ZÜRICH.
- 1.3. Xhamia jonë, QKSHP, përbëhet nga anëtarë të etnikumit shqiptar dhe të etnikumeve të tjera që pajtohen me këtë Statut dhe që kryesisht jetojnë në ZÜRICH dhe rrethinë.

2. SYNIMET

1. Synimi i QKSHP është ofrimi i mundësisë së mësimimit dhe praktikimit të Islamit brenda hapësirave të xhamisë si dhe, sipas mundësive, edhe jashtë saj, si në familje etj.
2. Synon krijimin e një pikëtakimi dhe platforme kulturore-fetare islame për anëtarët e saj dhe për të gjithë të interesuarit e tjerë.
3. Për ta arritur atmosferën e nevojshme për takime dhe për një nivel të nevojshëm për këmbim mendimesh, xhamia jonë merr një pozicion të qartë, në të cilin përfaqësohet vetëm pozicioni islam i së mesmes.
4. Synon ruajtjen dhe avancimin e interesave të anëtarëve të saj në mbarë territorin që ajo e mbulon.
5. Veprimtarinë e vet e mbështet në burimet e shëndosha të Islamit, në kushtetutën dhe ligjet në fuqi të Zvicrës, si dhe në këtë Statut.
6. Ekstremizmi dhe/ose fanatizmi i çfarëdo forme as nuk do të tolerohet e as nuk do të mbështetet nga QKSHP.
7. Angazhohet për një bashkëpunim të mirë e të ngushtë me të gjitha xhamitë përreth si dhe me të gjitha organizatat islame në Zvicër.
8. QKSHP angazhohet për integrimin e anëtarëve të saj në shoqërinë zvicerane dhe me këtë rast vepron në kuadër të Komunitetit Musliman Shqiptar në Zvicër (KMSHZ/DAIGS).
9. QKSHP është anëtare në organizatat islame në nivelin komunal, kantonal dhe nacional/federal, me të cilat i ndanë të njëjtat synime, mësimime e mënyrë veprimi.
10. QKSHP angazhohet për avancimin e dialogut ndërfaqësor dhe vë në dispozicion të gjitha mundësitë që ka për ta forcuar e për ta ruajtur paqen ndërfaqësore në shoqërinë vendase.
11. QKSHP është themeluar për një afat kohor të pacaktuar.

12. QKSHP obligohet për veprim të pavarur. Veprimtaria e saj nuk guxon të bjerë ndesh me synimet e lartpërmendura si dhe me parimet e Islamit.

13. I ruan marrëdhëniet shpirtërore me Bashkësitë Islame të vendlindjes: Maqedoni e Veriut, Kosovë, Shqipëri dhe Lugina e Preshevës.

3. MJETET FINANCIARE

3.1. QKSHP në bazë është e pavarur financiarisht.

3.2. Financimi i QKSHP sigurohet me anë të: kontributeve vjetore të anëtarësisë, subvencioneve të mundshme, dhuratave pa interes dhe të pakushtëzuara, testamenteve dhe trashëgimive, kontributeve të dashamirëve dhe afaristëve vendas, të ardhurave nga manifestimet dhe aktivitetet personale.

3.3. QKSHP nuk pranon donacione/dhurata nga persona a organizata të dyshimta.

4. ANËTARËT DHE ANËTARËSIA

4.1. Anëtarë të QKSHP janë familjet bërthamë me fëmijët e pamartuar deri në 21 vjeç (deri në 25 vjeç në qoftë se janë në studime) dhe që e njohin këtë statut dhe zotohen se do të veprojnë në kuadër të tij.

4.2. QKSHP njih:

Anëtarë të rregulltë
Anëtarë nderi

4.3. Anëtarësimi në QKSHP mund të kërkohet në çdo kohë. Për pranim në QKSHP vendos kryesia e xhamisë.

5. KONTRIBUTET E ANËTARËSISË

5.1. Shuma e anëtarësisë caktohet nga Kuvendi i QKSHP.

5.2. Anëtarësia duhet të paguhet brenda vitit kalendarik. Mundësia e pagesës me këste është e mundshme.

6. DALJA, PËRJASHTIMI DHE DORËHEQJA

6.1. Anëtarësimi shlyhet nëse:

- një anëtar ia përcjell me shkrim kryesisë daljen nga QKSHP.
- një anëtar për arsye bindëse, si p.sh. mospagesa e rregullt e anëtarësisë (QKSHP për sa vite, këtë e cakton kuvendi i xhamisë), veprimi kundër

synimeve dhe interesave të xhamisë etj, përjashtohet nga Kryesia i QKSHP (emri i shkurtuar i xhamisë).

- 6.2. Anëtarët që largohen vetvetiu ose që përjashtohen, nuk kanë të drejtë në pasurinë e QKSHP.

7. ORGANIZIMI

7.1. Organet e QKSHP janë:

- Kuvendi
- Kryesia
- Revizorët
- Këshilltarët

8. KUVENDI

8.1. Kuvendi është organi më i lartë i QKSHP (emri i shkurtuar i xhamisë). Ai thirret një herë në vit. Në rast nevoje mund të thirret edhe Kuvend i jashtëzakonshëm.

8.2. Kuvendi ka këto detyra:

- 1) ndryshon dhe miraton statutin e xhamisë,
- 2) shpall dhe organizon zgjedhjet brenda xhamisë,
- 3) përcakton numrin dhe zgjedh, respektivisht shkarkon anëtarët e kryesisë,
- 4) përcakton numrin dhe zgjedh, respektivisht shkarkon revizorët,
- 5) merr vendim për punësimin ose shkarkimin e imanit të rregullt, duke i përcaktuar edhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për kandidatët e mundshëm, sipas Rregullores për Punët e Imamëve Shqiptarë në Zvicër, të përpiluar dhe të miratuar nga KMSHZ-ja,
- 6) cakton shumën e anëtarësisë (pagesës vjetore të anëtarëve),
- 7) merr vendim dhe miraton projekte (ndërtim, renovim ose blerje të sendeve) të kryesisë që kushtojnë mbi _____ (sa mijë?) franga zvicerane,
- 8) miraton raportin dhe llogarinë vjetore të kryesisë,
- 9) miraton buxhetin vjetor të propozuar nga kryesia,
- 10) jep udhëzime dhe sugjerime për punën e imanit, të kryesisë dhe të revizorëve,
- 11) miraton themelimin e forumeve apo të grupeve të ndryshme punuese,
- 12) sjell vendimin për anëtarësim të xhamisë në organizatat e ndryshme islame dhe të tjera brenda Zvicrës,
- 13) sjell vendime – në përputhje me ligjet në fuqi të Zvicrës – për të gjitha çështjet e tjera që nuk janë përmendur në këtë statut.

- 8.3. Vendimet merren me anë të shumicës absolute të të pranishmëve në Kuvend.
- 8.4. Kuvendi është i vlefshëm dhe vazhdon punimet kur në të marrin pjesë së paku gjysma (1/2) e anëtarëve. Vendimet për çështje madhore, si ndryshimi i statutit, miratohen me shumicën e cilësuar prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të pranishëm).
- 8.5. Kuvendi zhvillohet në gjuhën shqipe, mirëpo sipas nevojës edhe në njëërën gjuhë zyrtare të vendit.
- 8.6. Ftesa për kuvend dhe pikat e rendit të ditës duhet të bëhen të njohura më së voni dy javë para zhvillimit të kuvendit.

9. KRYESIA

- 9.1. Kryesia përbëhet nga më së paku pesë (5) anëtarë dhe më së shumti (11): kryetari, nënkryetari, sekretari, arkëtari dhe imami si anëtar me të drejta të barabarta me gjithë anëtarët tjerë të kryesisë dhe me të drejtë vote.
- 9.2. Kryesia zgjidhet një herë në katër vjet. Rizgjedhja është e mundshme.
- 9.3. Për t'u kandiduar për anëtar të kryesisë, kusht është që personi të ketë qenë anëtar në dy vitet e fundit, si edhe anëtarët e familjes së tij që janë nën anëtarësinë e tij.
- 9.4. Kryesia i kryen këto detyra:
 - 1) i kryen punët e xhamisë dhe e përfaqëson atë në publik,
 - 2) zbaton vendimet e kuvendit të xhamisë,
 - 3) kujdeset për realizimin e plotë dhe konsekuent të synimeve të xhamisë,
 - 4) siguron mjetet financiare për funksionimin e xhamisë,
 - 5) udhëheq racionalisht me pasurinë e xhamisë dhe mban kontabilitet,
 - 6) paraqet raport dhe program vjetor për punën e vet në kuvendin e xhamisë,
 - 7) propozon buxhetin dhe bën llogarinë vjetore të xhamisë,
 - 8) me kërkesë të kryetarit, të shumicës së anëtarëve të kryesisë ose të 1/5 së anëtarëve të xhamisë, kryesia fton mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendit,
 - 9) Kryesia i propozonë anëtarët e ri për kryesi, si dhe është e mundur që edhe dikush tjetër të propozojë ndonjë anëtarë tjetër, pastaj në fund kuvendi i miratonë apo i refuzonë të propozuarit për kryesi.
 - 10) i propozon kuvendit krijimin e forumeve (departamenteve a sektorëve) të përhershme dhe/apo të përkohshme për punë të caktuara të saj,
 - 11) i propozon kuvendit anëtarësimin e xhamisë në ndonjë organizatë islame ose tjetër brenda Zvicrës,
 - 12) ka të drejtë të angazhojë njerëz kompetentë për realizimin e projekteve ose kryerjen e punëve të caktuara të saj që kërkojnë aftësi dhe zotësi të veçanta. Këta paguhen dhe janë përgjegjës para kryesisë së xhamisë.

- 9.5. Anëtarët e kryesisë mund të japin dorëheqje duke iu përmbajtur një afati njëmuajor në fund të çdo muaji. Dorëheqjen ia shtrojnë me shkrim kryesisë së xhamisë.
- 9.6. Në rastet e pikës 9.5 kryesia i zëvendëson këta me anëtarë të tjerë të xhamisë deri në kuvendin e radhës të xhamisë. Kuvendi pastaj vendos ose për vazhdimin e mandatit të tyre ose për zëvendësimin e tyre.
- 9.7. Kryesia mban mbledhje aq shpesh sa këtë e kërkon nevoja, më së paku një herë në 3 muaj. Mbledhjet e saj i fton kryetari me kërkesë të vet ose me kërkesë të më së paku 3 anëtarëve të kryesisë. Mbledhjet i udhëheq kryetari, kurse në mungesë të tij, nënkryetari ose sipas marrëveshjes mes kryesisë.
- 9.8. Vendimet merren me shumicë votash, me këtë rast secili anëtar kryesie ka të drejtë një votë. Në rast të barazimit të votave, kryetarit i njihet vota e dyfishtë. Kryesia mund të sjellë vendime në rast se të pranishëm janë së paku shumica absolute e të gjithë anëtarëve të kryesisë. Vendimet mund të merren edhe me shkrim përmes postës normale ose asaj elektronike. Edhe vendimet e këtilla duhet të protokollohen.
- 9.9. Për secilën mbledhje të kryesisë mbahet procesverbal në gjuhën shqipe (sipas nevojës edhe në ndonjë gjuhë zyrtare të Zvicrës) nga ana e sekretarit dhe i njëjti arkivohet.
- 9.10. Dokumentet zyrtare të xhamisë nënshkruhen gjithnjë nga dy persona: kryetari dhe një anëtar i kryesisë.
- 9.11. Anëtarët e kryesisë punën e tyre e kryejnë pa pagesë. Atyre u kompensohen harxhimet e rrugës për punë zyrtare dhe të tjerat që kanë të bëjnë me punët e xhamisë.
- 9.12. Kryesia ka të drejtë të hartoj një rregullore të brendshme për funksionimin e saj dhe të përcaktojë me përpikëri detyrat e secilit anëtar. Kjo rregullore, përpara se të hyjë në fuqi, duhet të miratohet në kuvendin e ardhshëm.
- 9.13. **Përrjashtimi nga votimi**
Në rast votimi, anëtarët përrjashtohen nga vendimmarrja kur:
- a. Kanë interes personal në çështje;
 - b. Me anëtarin e prekur të kryesisë (bordit):
 1. Janë ose kanë qenë të martuar;
 2. Janë të afërm në vijë të drejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e tretë, ose të afërm përrmes martesës;
 3. Përr arsye të tjera, sidomos përr shkak të miqësisë apo armiqësisë, gjenden në një pozitë që mund t'i bëjë të paanshëm.
- 9.14. **Detyrimi përr ruajtjen e fshehtësisë**

Të gjithë anëtarët e kryesisë (bordit) obligohen të ruajnë fshehtësinë lidhur me informacionet konfidenciale, si dhe me rrjedhën dhe përmbajtjen e diskutimeve të brendshme dhe proceseve vendimmarrëse. Ky detyrim mbetet në fuqi edhe pas largimit nga funksioni.

9.15. Shkarkimi

Një anëtar i kryesisë (bordit) mund të shkarkohet para përfundimit të mandatit të rregullt vetëm për arsye të rëndësishme dhe me vendim të kryesisë së QKSHP.

Një vendim i tillë është i vlefshëm vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar së paku 3/4 e të gjithë anëtarëve të kryesisë së QKSHP. Për shkarkim kërkohet një shumicë e kualifikuar prej 2/3 e votave të vlefshme të dhëna.

10. REVIZORËT

- 10.1. Kuvendi i xhamisë e cakton numrin e revizorëve dhe i zgjedh ata për një periudhë katërvjeçare. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.
- 10.2. Revizorët mund të zgjidhen nga mesi i anëtarëve të xhamisë ose edhe nga njerëz të jashtëm që janë kompetentë për këtë punë.
- 10.3. Revizorët e kontrollojnë llogarinë vjetore të kryesisë dhe për këtë i raportojnë me shkrim kuvendit të xhamisë.



11. Këshilltarët

- 11.1. Kryesia i propozonë Këshilltarët e ri, si dhe është e mundur që edhe dikush tjetër të propozojë ndonjë këshilltarë tjetër, pastaj në fund kuvendi i miratonë apo i refuzonë të propozuarit për kryesi.
- 11.2. Këshilltarët munden me qenë 3-5 persona.
- 11.3. Këshilltarët kanë rolin e ndërlidhjes ndërmjet kryesisë (bordit) dhe anëtarëve të shoqatës (QKSHP).
- 11.4. Ata kanë të drejtë ta këshillojnë kryesinë (bordin) në çështje të rëndësishme të shoqatës (QKSHP).
- 11.5. Gjithashtu e ndihmojnë kryesinë (bordin) për të ruajtur mjedisin e shoqatës (QKSHP) dhe marrëdhëniet e mira mes të gjithë anëtarëve.

12. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

- 12.1. Ndryshimi dhe plotësimi i këtij statuti bëhet vetëm në kuvendin e xhamisë (ku marrin pjesë së paku $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të xhamisë dhe) me vendim të 2/3 të kuvendarëve të pranishëm.
- 12.2. Vetëm pasuria e xhamisë vihet në detyrim zhdëmtimi për angazhimet e saj.
- 12.3. Përfshihet dorëzania personale e anëtarëve të xhamisë dhe e anëtarëve të kryesisë së xhamisë.
- 12.4. Shuarja eventuale e xhamisë mund të bëhet vetëm në mbledhje të jashtëzakonshme të kuvendit, e cila thirret vetëm për këtë çështje dhe me lajmërim të vendimit të propozuar së paku një muaj përpara. Për këtë nevojitet prania e më së paku 2/3 të kuvendarëve dhe me së paku vota e shumicës absolute të kuvendarëve (anëtarëve) të xhamisë.
- 12.5. Në rast shuarjeje, pasuria ekzistuese e xhamisë i dhurohet ndonjë organizate islame në Zvicër, e cila ndjek synime dhe filozofi të përafërt me të xhamisë. Për këtë vendos kuvendi i xhamisë.
- 12.6. Gjuhë komunikimi brenda xhamisë është gjuha shqipe, sipas nevojës edhe ndonjëra nga gjuhët zyrtare të vendit. Gjithashtu, dokumentacioni i xhamisë mbahet në gjuhën shqipe dhe sipas nevojës në ndonjë gjuhë zyrtare të vendit.
- 12.7. Në rast të mosmarrëveshjeve midis organeve të ndryshme të xhamisë mund të angazhohet një gjykatë arbitrazhi në qytetin e ZÜRICH. Vendimet e kësaj gjykate janë përfundimtare.
- 12.8. Për të gjitha çështjet e tjera që nuk janë përmendur në këtë statut vlen e drejta civile zvicerane (ZGB).
- 12.9. Ky statut hyn në fuqi në datën e miratimit ose ndryshimit nga ana e kuvendit të xhamisë.

Miratuar më 28.09.2025, në Zürich.

Kryetari i xhamisë:  (emri, mbiemri dhe nënshkrimi)
Sekretari i xhamisë:  (emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Komisioni për hartimin e këtij statuti:

1. Rejhan ef. Neziri – kryetar
2. Halil ef. Avdulli - anëtar
3. Ismail Ademi – anëtar
4. Muhamed Bojniku - anëtar
5. Mustaf Veseli - anëtar
6. Nehat ef. Ismaili – anëtar
7. Sherif Tupani - anëtar